



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 133/2024
Prishtinë, më 14.5.2024, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

I ftuar: Mentor Hyseni, Kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP.

Pjesëmarrës tjerë: Sami Gashi, Sali Hoxha - GP LVV, Festim Bytyçi - GP AAK, Ema Krasniqi – KDI, Duresa Tafa – Kuvendi, Syzana Surdulli, Avni Ajdini, Xhevdet Neziraj, Gent Nushi, Arben Limani, Adem Selishta - AKP dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit, ndihmuar nga Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 2.5.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin 2023;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Driton Hyseni, kërkoi të shtohet në rend dite, votimi i ekspertëve për angazhim në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga z.Hyseni.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 2.5.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 2.5.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues

Kryetari theksoi se lidhur me është pikë të rendit të ditës, ia kaloi fjalën kryesueses së grupit të punës znj. Statovci, që ta arsyetoj raportin me amendamente.

Jeta Statovci, tha se bazuar në punën e tij, grupi punues ka mbajtur mbledhjet e tij dhe ka organizuar dëgjim publik me palët e interesuara. Si grup punues kemi shqyrtuar rekomandimet e palëve të interesit dhe kemi amendamentuar projektligjin në kuadër të materialeve të pranuar, të cilat kryesisht janë teknike dhe për të bërë ligjin me efektiv, propozoj që të hidhet në votim projektligji së bashku me amendamentet e tij.

Pas debatit, Komisioni, më 6 (gjashtë) vota Për, nxori këtë:

Rekomandim

- 1. Miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;*
- 2. Raporti procedohet tutje të Komisionet e përhershme për vlerësim sipas procedurës.*

4. Votimi i kandidatëve të përzgjedhur për angazhim si ekspert në grupin punues për monitorimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike

Kryetari, lidhur me këtë pikë ia kaloi fjalën deputetit Driton Hyseni.

Driton Hyseni, tha se grupi punues ka përzgjedhur dy kandidatë për angazhim si ekspert në grupin punues për monitorimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nga gjashtë që kanë aplikuar. Ai tha, se njëri ekspert do të kompensohet nga buxheti i Komisionit, kurse tjetri do të kompensohet nga organizata e shoqërisë civile Demokraci Plus. Ai tha, se grupi punues, për çështje juridike ka përzgjedhur që të angazhojë si ekspert z. Hilmi Jashari, kurse për çështje nga fusha e ekonomisë është përzgjedhur z. Lulzim Beqiri. Ai propozoi votimin për angazhimin e ekspertëve të lartcekur në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Pas debatit, Komisioni, më 6 (gjashtë) vota Për, nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Hilmi Jashari dhe Lulzim Beqiri, angazhohen si ekspertë të jashtëm për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike;*
 - 1.1. Shërbimet e ekspertit Hilmi Jashari, mbulohen nga buxheti i Komisionit;*
 - 1.2. Shërbimet e ekspertit Lulzim Beqiri, mbulohen nga organizata DPlus;*
- 2. Ngarkohet kryesuesi i grupit punues dhe koordinatori i Komisionit, të përgatisin termat e referencës, ku definojnë përgjegjësitë e ekspertëve, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.*

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin 2023

Kryetari, tha se në bazë të nenit 20, të Ligjit nr.04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe e bën publik raportin vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë: pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë; pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve të cilat mbahet nga Agjencia në mirëbesim; listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë; listën e transaksioneve të kryera dhe të realizuara gjatë vitit, për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull; listën e ndërmarrjeve të likuiduara; dhe listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit. Për ta prezantuar raportin ia kaloi fjalën Mentor Hysenit, kryesues i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe mandej hapim debat.

Mentor Hyseni, Kryesues i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, tha se në pika të shkurta ky raport lidhet me këto fusha: të arriturat kryesore, administrimi dhe shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%), shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve për Ndërmarrjet Shoqërore, aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së, përmbledhje lidhur me financat. Ai tha, se të arriturat kryesore janë realizimi i shitjeve të aseteve në baza mujore, gjatë vitit 2023 shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm është 2,941,587 euro. Gjatë vitit 2023 janë shpallur gjithsej 14 lista fillestare për 20% e punëtorëve, 4 lista finale me përfitues gjithsej 6,507 punëtorë. Për periudhën janar - dhjetor 2023 është inkasuar shuma prej 4,891,948 euro. Gjatë vitit 2023, janë përmbyllur 5 Ndërmarrje Shoqërore sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Janë identifikuar dhe vënë nën administrim të AKP-së 3 asete të reja, që më herët nuk kanë qenë në regjistër të Agjencisë. Raportet financiare për të hyrat e realizuara nga shitja e aseteve, shpronësimet, qiraja dhe tarifatat për pjesëmarrje në tender, për vitin 2023 (si dhe krahasimet me vitet paraprake) janë paraqitur në detaje në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim. Sa i përket sfidave dhe pengesave, më poshtë kemi paraqitur faktorët e jashtëm të cilët kanë një rol kyç në administrimin më të mirë të aseteve, shitjen, likuidimin e tyre, dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative. Faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në periudhat pasuese janë paraqitur si më poshtë: lëndët e pazgjidhura nëpër gjykata. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Gjykatat Themelore kanë kapacitete të limituara sa i përket shqyrtimit të lëndëve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Janë mijëra raste gjyqësore që duhet trajtuar në instanca të ndryshme, vonesa në qasjen e dokumenteve kadastrale. Komunitat janë një ndër faktorët relevantë në përshpejtimin e kohës dhe përgatitjes të aseteve për shitje. Janë 1,380 asete të cilat janë shpronësuar prej tyre 777 asete i përkasin NSh-ve kurse 603 asete Ekonomive Pyjore, dhe për të cilat duhet paguar mjetet nga ana e Qeverisë, ofertat e blerësve, mund të ketë asete, ashtu siç ka pasur raste këtë vit të cilat nuk janë atraktive për tërheqjen e investitorëve/blerësve, faktor ky i cili ndikon në ritenderimin e aseteve për shitje për shkak të mungesës së ofertave, mungesë e dokumentacionit në përcaktimit të statusit të NSh-ve dhe trajtimit të shitjeve të aseteve të tyre. Komercioni është ndër sfidat më të mëdha të Agjencisë. Borxhi i akumuluar ndër vite nga shpronësimet e pronës shoqërore në vlerën prej 59 milionë Euro, që rrjedhimisht ndikon në likuidimin e NSh-ve si dhe në implementimin e strategjisë përmbylëse të AKP-së. Të gjithë këta faktorë të shënuar më lartë, ndër vite kanë qenë dhe janë ende sfida dhe pengesa lidhur me procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Gjithsesi, këto sfida vit pas viti janë bërë më të lehta, kjo për shkak të ngritjes të

kapaciteteve ndërinstitucionale, por ka shumë punë për të bërë në nivel qendror dhe lokal, sidomos në shqyrtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Kosovës dhe komunave, të cilat janë faktorë kyç në përshpejtimin e proceseve.

Kryetari, pyeti në lidhje me premtimin e Qeverisë për mbylljen e AKP-së, kur konsideroni se AKP do të mbyllet? Po ashtu në lidhje me asetet për kalim në Fondin Sovran, ky fond ende është projektide, a keni alternative nëse nuk mund të mbyllet APK-ja, dhe nëse nuk do të themelohet Fondi Sovran, çka do të ndodh me ato asete të parapara për kalim në Fondin Sovran?

Mentor Hyseni, tha se ne kemi hartuar një strategji me të cilën parashihet mbyllja e AKP-së, për këtë arsye kemi bërë klasifikimin e të gjitha aseteve në 6 kategori. Mbyllja e AKP-së nuk varet vetëm nga AKP-ja, janë diku 13500 lëndë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, por aktivitetet kryesore të AKP-së, siç janë shitja dhe transformimi i pronës mund të përfundohen deri në fund të këtij viti. Pjesa e aseteve të Fondit Sovran, detyrimisht varemi nga ky fond dhe nuk është në dorën tonë, 97% e pronave do të marrin karakter publik, prej tyre diku 45% e tyre janë duke u trajtuar me Ligjin e tokave bujqësore dhe pjesa tjetër e tyre jemi duke i trajtuar për bartje në Agjencinë e Pyjeve. Pjesa e aseteve në Fondin Sovran, janë 477 asete, ku 84 prej tyre klasifikohen si asete që do të kalojnë në Fondin Sovran, diku 290 tjera prapë do të trajtohen nga AKP-ja. Ne e kemi paraparë që edhe nëse nuk bëhet Fondi Sovran, Ligji për tokat bujqësore është në përgatitje e sipër dhe më këtë ligj mund t'i trajtojmë këto 45% të tokave bujqësore dhe pjesa tjetër të kalohet në Agjencinë e Pyjeve, besoj që 97% e të portfolios së AKP-së mbyllet gjatë këtij viti.

Kryetari, tha se keni deklaruar se AKP-ja ka rreth 1600 asete dhe tani kanë mbetur rreth 400 asete, çka ndodhi me asetet e AKP-së, ku mbeten asetet tjera. Dhe a keni ndonjë zotim nga ana e Qeverisë për shpronësim të aseteve të AKP-së, të cilat do të barten në Agjencinë e Pyjeve, çdo ndryshim për asetet e sjella në Kuvend nga viti 2022 në vitin 2023. Kryetari, kërkoi që të silltet një raport zyrtar me arsyet e lëvizjes së aseteve dhe arsyeshmëria e ndryshimit të tyre.

Mentor Hyseni, tha se kur është bërë lista fillestare e aseteve që do të barteshin në Fond Sovran e cila është sjellë në Kuvend ka qene një selektim i thjeshtë dhe është paraparë që të gjitha tokat bujqësore të kalohen në Fond Sovran, më vonë i kemi klasifikuar tokat që do të barteshin në Fond Sovran dhe pjesa e tokave të cilat janë në kategorinë e pyjeve i kemi klasifikuar për bartje në Agjencinë e Pyjeve. Në lidhje me ristrukturimin e aseteve në AKP, vetëm toka bujqësore janë diku rreth 15000 parcela, vetëm këto parcela, më herët APK-ja i ka cilësuar si 1600 asete, i ka grupuar sipas zonave kadastrale për me i transformua, ne si bord e kemi nxjerr numrin e sakte të parcelave, të cilat më herët kanë qenë të grupuara, prona nuk mund të transformohet pa një vendim të bordit. Ai tha, se mund t'ia sjellë Komisionit ortofoton e parcelave, në mënyrë të detajuar për secilin rajon veç e veç. Tokat të cilat do të kalohen në Agjencinë e Pyjeve, për zotimet e Qeverisë, duhet të pyetet Qeveria.

Pal Lekaj, në lidhje me raportin, pyeti rreth marrjes se dy auditorëve nga KEK-u, cila është lidhshmëria e juaj me ata auditorë dhe a keni punuar më herët me ta, konkretisht pyes për zëvendës drejtorin dhe cila është lidhja e juaj me të? Në lidhje me listimin e aseteve, derisa nuk kemi listim të saktë të aseteve dhe çmim të saktë të aseteve, si mund t'i ofrojmë Fondit Sovran asete pa bërë një analizë paraprake. Lëvizja e shifrave të aseteve nxjerr në pah mungesë qasja

analitike e kësaj çështjeje. Në faqe 12 të raportit, flitet për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, veçanërisht për ndërmarrjet shoqërore N. SH. “Auto Makedonia” dhe N. SH “Borba” dhe thuhet se brenda aftit ligjor, deri me 31 dhjetor 2023 janë pranuar 4 kërkesa kreditore, a mund të na sqaroni më shumë rreth procedurave që janë duke u ndërmarrë, ku gjenden asetet dhe kush janë kreditorët pretendentë? Në këtë raport, po ashtu, thuhet se ofruesit të shërbimeve profesionale i skadon kontrata më 30 qershor 2024, a janë duke u zhvilluar veprimet e nevojshëm në AKP që të mos ketë vakum në ofrimin e shërbimeve profesionale? Në raport, po ashtu, thuhet se numri i ndërmarrjeve shoqërore të mbyllura me aktvendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në vitin 2023 është 5 ndërmarrje, ndërsa i tërë procesi deri me 31 dhjetor 2023, është 46 ndërmarrje, kërkojmë të sqarohet procesi i ndërmarrjeve shoqërore të mbyllura me aktvendime të Dhomës së Posaçme dhe pse duhet të mbyllet ato ndërmarrje?

Mentor Hyseni, tha se në bazë të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, parashihet që 2/3 e Komitetit të Auditimit me qenë anëtarë të jashtëm profesionistë dhe ne e kemi një përbërje prej 3 anëtareve, njëri nga ata është që ka punuar më herët në KEK dhe është anëtar i Komitetit, në përputhje me bazën ligjore. Sa i përket zëvendës drejtorit, duhet ta cekim që është hera e parë që ne AKP zgjidhet një zëvendës drejtor me konkurs, ai është Burim Leci i cili në vitin 2015 ma ka shkëput kontratën sa isha zyrtar në KEK, kam vendim për këtë dhe procesi është në gjykatë sepse e kam apeluar, dhe aq është ndikimi im, sa nuk kam ndikuar asgjë në përzgjedhjen e tij në cilësinë e zëvendës drejtorit në AKP.

Pal Lekaj, pyeti se pse ua ka ndërpre kontratën Burim Leci në vitin 2015?

Për shkak të përfshirjes edhe të deputeteve të tjerë në debat, kryetari propozoi pauzë prej 5 minutash me arsyetimin e qetësimin të debatit.

Mimoza Kusari – Lila, tha se askush nuk ka te drejtë të cenojë integritetin e askujt dhe të fyejë anëtarët e kolegëve deputet, zoti Lekaj me dy komente sulmoi kolegun deputet z. Driton Hyseni dhe kryesuesin e bordit të AKP-së. Kjo është gjuhë joparlamentare dhe nuk lejohet.

Armend Muja, ju thoni se Burim Leci në kohën kur ishit në KEK ua ka shkëputur kontratën, do donim një sqarim rreth gjithë kësaj çështjeje.

Mentor Hyseni, tha se për procesin e shkarkimit tim në vitin 2015, dua të rezervohem sepse është temë personale dhe rasti është në gjykatë. Në kohën e shkarkimit unë kam qenë drejtor i Auditimit të Brendshëm në KEK kurse ai ka qenë kryesues i Komitetit të Auditimit, nuk kam pasur asnjëherë raporte personale me të. Komisioni përzgjedhës në AKP e ka propozuar dhe ne si bord e kemi votuar, është proces ligjor të cilin ne nuk mund ta shmangim, nga dy kandidatët, Burimi Leci ka pasur vlerësim më të lartë dhe e kemi zgjedh. Në lidhje me pyetjen rreth vlerësimit të aseteve, për çdo aset në AKP, ne kemi vlerësim dhe kur e qesim në tender publik, nëse nuk e arrin atë vlerë të cilën e kemi të përcaktuar, nuk e japim, mirëpo, shpronësimi nuk na pyet, kur Qeveria dëshiron të shpronësojë, vendos për çmimin dhe ne nuk kemi dorë në atë çështje. Sa i përket ofruesve të shërbimeve, ne e kemi pasur një kontratë me ofruesit e shërbimeve, e cila ka qenë më e lira në 10 vitet e fundit, ajo kontratë skadon në qershor të këtij viti, tani propozimi ynë ka qenë të mbulojmë vetë si AKP shërbimet profesionale, dhe në suaza të Ligjit të prokurimit, e kemi zgjatë afatin e kontratës deri në fund të vitit.

Arben Limani, drejtor menaxhues në APK, tha se në lidhje me N. SH. “Makedonia” dhe N. SH. “Borba”, një aset i N. SH. “Borba” është në lagjen e njohur si Kurriz, ndërsa për N. SH. “Makedonia”, një aset është në lagjen Lakërishtë. Ndërsa për kërkesa kreditorëve nuk kam informacione të sakta, por mund të kërkonim me shkrim në ua dërgojmë. Sa i përket mbylljes së Ndërmarrjeve Shoqërore, është proces që historikisht na paraqet vështirësi me numrin e mbylljes së tyre, kur shiten asetet e rëndësishme përmes privatizimit, mbeten asetet e parëndësishme të paprivatizuara dhe futet ndërmarrja në likuidim dhe shiten si asete të tjera, përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Për shkak të angazhimeve të tjera, kryetari e lëshoi mbledhjen - nga këtu e tutje kryesimi i mbledhjes u bë nga znj. Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë e Komisionit.

Kryesuesja, ia kaloi fjalën deputetit Armend Muja.

Armend Muja, pyeti në lidhje me listën e aseteve të kategorizuara dhe kërkoi të sjellët kjo listë e detajuar e aseteve të AKP-së. Meqenëse kemi një plan për mbyllje të AKP-së, lista totale e shitjeve të AKP-së, nga fillimi është 904 milionë e 783 mijë euro, nga të cilat të hyra nga shitja e aseteve 789 milionë, 62 milionë nga qiratë, 35 milionë nga interesi i fituar dhe të hyra të tjera 7 milion, kjo është në bazë të raportit vjetor, nga këto, shpenzime janë 738 milionë euro, dhe në llogari të BQK-së janë 166 milionë euro, për të cilat ju thoni se nuk aplikohet interes. Cila është logjika e mbajtjes së mjeteve në llogari të BQK-së dhe mos të investohen në letra me vlerë qeveritare, të cilat me një afat faturimi mund të shkon në interes tuaj. A keni pasur diskutime për këtë çështje?

Mentor Hyseni, tha se meqenëse AKP-ja e ka hartuar strategjinë për mbyllje deri në fund të vitit, dhe shpërndarjet e parapara për vitin 2023 dhe 2024 janë goxha më dinamike se sa vitet e mëhershme dhe kemi menduar se ndoshta kjo mund të këtë ndonjë vlerë deri në fund të vitit, por ne po ashtu, deri në fund të vitit do të kemi shumë shpërndarje të mjeteve tek kreditorët.

Armend Muja, pyeti për vitin 2024 dhe 2025, sa është vlera e menduar e shpërndarjes për kreditorët dhe sa ka shpërndarje të 20% i punëtorëve. Sa i përket Fondit të transferuar në buxhetin e Republikës së Kosovës, ju thoni se deri në vitin 2023, këtij fondi në emër të mjeteve tepriçë, siç parashihet ligji i AKP-së, ia keni dhënë 389 milionë euro.

Mentor Hyseni, tha se mund të bëjmë një analizë të shpërndarjes së keshit dhe me ua ofruar si lëvizje e saktë e shpërndarjes së paraparë.

Armend Muja, tha se shuma totale e disbursimit të 20% për punëtorët është diku 163 milionë euro, a mund ta kemi një raport, sa mjete janë shpërndarë për çdo vit veç e veç, nga viti 2008 dhe sa është numri i përfituesve. Ai theksoi se në faqen 15 të raportit, theksohet për sa i përket problematikes së bartjes së një prone në emër të Komunës së Pejës, në listë janë 18 objekte pa përfshirë edhe tokat bujqësore që pritet të barten në Fondin Sovran, Komuna e Pejës nuk është duke e zbatuar vendimin e Gjykatës, për këtë arsye AKP-ja i ka dërguar shkresë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, gjithashtu në listë janë 13 objekte që janë brenda parkut

kombëtar Sharri, ku është problemi i kësaj çështje dhe a mund ta kem letrën të cilën ia keni dërguar ministrisë?

Arben Limani, lidhur me rastin ku komuna e Pejës para disa vitesh, ka kthyer në emër të komunës disa asete të AKP-së, tha se jemi në procedurë gjyqësore. Ne e kemi fituar rastin deri në Gjykatën e Apelit, të cilin aktvendim nuk e ka zbatuar komuna e Pejës.

Armend Muja, pyeti në lidhje me inkasimin nga qiraja tek Hoteli Grand, ku inkasimi për vitin 2021 ka qene 486 mijë euro kurse ne vitin 2023 ka qene 766 mijë euro, çka ka ndikuar në rritjen e vlerës së inkasimit.

Arben Limani, tha pjesërisht ka ndikuar auditimi dhe pjesërisht inkasimi i borxhit të vjetër.

Armend Muja, kërkoi një tabelë në të cilën do të paraqiten të gjitha asetet dhe faturimi për to që nga viti 2008. Z. Muja paralajmëroi përfaqësuesit e AKP-së për informacionet e mundshme të cilat do të duhet të jenë të gatshme për raportim në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere.

Driton Hyseni, pyeti rreth qiradhënies, ku siç pohuat zoti kryesues është rritur për 30 %, ndërsa tek qiraja e inkasuar për ndërmarrjet shoqërore në likuidim, nuk e kemi një rritje të tillë, pse nuk ka pas një rritje të tillë edhe në këtë rast?

Mentor Hyseni, tha se lista e cila u kërkua nga deputeti paraparak, me të dhënat e të hyrave, inkasimeve dhe borxheve do të jetë lista që do të reflektojë drejt në këto të dhëna që po kërkoni. Kjo liste do t'i dërgohet Komisionit.

Driton Hyseni, si ka qenë impakti tek operatorët të cilët i shfrytëzojnë asetet e AKP-së me qira? Ai pyeti edhe rreth kërkesës së komunave që disa asete të AKP-së të kalojnë në emër të tyre, për interes të përgjithshëm, konkretisht pyeti rreth pronës e cila është në hyrje të rrugës për në lagjen Veternik në Prishtinë, tek rrethi ku është i vendosur flamuri shtetëror dhe e cila pronë është nën menaxhim të AKP-së, a ka dorëzuar Komuna e Prishtinës kërkesë që ta ketë në shfrytëzim këtë parcelë për nevoja të saja?

Arben Limani, tha se mbi 99% e operatoreve të cilët shfrytëzojnë asetet e AKP-së me qira janë pajtuar me këtë rrije, ka disa ankesa të cilat janë bërë në Dhomën e Posaçme.

Mentor Hyseni, tha se qëllimi ynë është që pronat të lëshohen me qira dhe të rritet vlera e pronës. Kemi raste kur Komuna e Prishtinës ka marrë pronë me qira për shfrytëzim të caktuar dhe ka filluar që tokat të cilat i ka pasur me qira ka filluar ti shfrytëzojë për veprimtari të tjera të cilat kane qenë jashtë objektivave për të cilat iu janë dhëna me qira, Komuna e Prishtinës është jashtëzakonisht joserioze në trajtim të pronave të AKP-së, dhe nuk ka treguar interes për shpronësim të pronave që mund të jenë me interes për të.

Driton Hyseni, çështja e listës së aseteve që duhet të kalojnë në Fondin Sovran, nuk është diskutuar ende që ka një liste finale e aseteve që do të kalojnë në Fondin Sovran, në vizionin tuaj, a do të kemi shpejt një listë finale të aseteve? Ju përmendet po ashtu, se afër 3 milion euro u

janë paguar kreditorëve, a mund të kemi informacione për të gjitha pretendimeve që kanë kreditorët ndaj aseteve të AKP-së?

Mentor Hyseni, tha se pjesa e tokave, që i ceka rreth 32 mijë hektarë, dikur rreth 45% e tyre, nëse nuk themelohet Fondi Sovran, është paraparë të kalohet në Ministrinë e Bujqësisë, nëse Qeveria pastaj e vlerëson që duhet të kalohen në Fondin Sovran, mund ta bëjë pa problem. Pjesa e aseteve të tjera janë duke u vlerësuar dhe nuk kemi një numër final të tyre. Sa i përket kërkesave kreditore, maksimumi i kërkesave të aprovuara nga gjykata janë 10%, në nuk jemi të rrezikuar nga kërkesat kreditore nëse pronën shoqërore duam ta kalojmë në pronë publike. Me vetëm 2.67% të pronës të cilën dëshirojmë ta shesim, ne mbulojmë 160% të kërkesave kreditore.

Armend Muja, pyeti rreth pronës “ABC Genci”, a ka kaluar në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe kërkoi dosjen për këtë proces.

Arben Limani, theksoi se ka kaluar në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe të gjitha procedurat gjyqësorë kanë përfunduar për këtë rast.

Armend Muja, pyeti rreth gjetjeve të auditorit, sa i përket rasteve të 18 punëtoreve të cilët nuk kane qene të evidentuar, a është trajtuar ky problem dhe rasti i konfliktit të interesit duhet të informohen për këto shkelje që të mos tolerohen shkelje të tilla. Po ashtu ai pyeti në lidhje me padinë e ish Drejtorit Menaxhues z. Ekrem Hajdari.

Arben Limani, tha kemi kërkuar me shkrim të gjitha informatat për të gjithë punëtorët, masat janë marrë ndaj të gjithë atyre që nuk kanë pasur arsyetime, janë shqiptuar vërejtjeje me shkrim. Në lidhje me padinë e z. Ekrem Hajdari, ende nuk ka një aktvendim nga gjykata.

***Kryesuesja** konstatoi shterjen e debatit, tha se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionet për Financa Publike, mandej e procedojmë në seancë draft rezolutën siç parashihet me ligj dhe rregullore.*

6. Të ndryshme

Kryesuesja, njoftoi se në mbledhjen e ardhshme do të shqyrtohet raporti vjetor i ARRU-së për vitin 2023.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit